

**STATUT**  
**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**WiseWorkers SHPK**

**Neni 1**

**Ortaku**

Sot, më datë 08 / 07 /2022, themelohet Shoqëria “**WiseWorkers**” SH.P K. nga ortaku i vetëm:

1. Znj. **Migena Paçuku**, shtetase shqiptare, lindur me 17.07.1991, Rrëshen, rezident në adresën: Nikolla Jorga, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 034779243, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

**Neni 2**

**Emri**

Emri i shoqërisë është “**WiseWorkers**”, (më poshtë referuar si “**Shoqëria**”).

**Neni 3**

**Selia e Shoqërisë**

- 3.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Rruga *Nikolla Jorga, Pallati Begeja, Nr. 8, Ap 24, Tiranë, Shqipëri*.
- 3.2 Shoqëria mund të hapë degë, zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

**Neni 4**

**Forma ligjore**

- 4.1 “**WiseWorkers**” është shoqëri e se drejtës shqiptare dhe është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- 4.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër ligjore në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 5**

**Kohëzgjatja**

Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj tregtar për një periudhë të pakufizuar.



## Neni 6

### Objekti i aktivitetit

#### 6.1 Fusha kryesore e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë:

*Shërbime konsulencë në fusha të ndryshme, shërbime dhe konsulencë në real estate (pasuri të paluajtshme). Shërbime konsulencë për marketing, krijim i eventeve, hulumtimi i tregut, rekrutim i stafit për shoqëritë e huaja ose shqiptare për punë në Shqipëri; administrim i personelit; kërkim i publikimeve për tendera dhe projekte të ndryshme startup; shërbime të teknologjisë së informacionit, shërbime konsulencë dhe projektimi arkitektonik, shërbime konsulencë në arredim të brendshëm (interior design). Zhvillimi i marrëdhënieve ekonomike, tregtare, shoqërore dhe kulturore midis shteteve të huaja dhe Shqipërisë. Krijimi dhe lehtësimi i kontratave për bashkëpunim, përdorimi i mjeteve të ndryshme për të shpërndarë informacion mbi ekonominë, tregun, taksat, legjislacionin; shërbime konsulencë në fusha të ndryshme, Fitim direkt ose indirekt të interesave në kompani të tjera që kanë një objekt të ngjashëm me atë të shoqërisë në Shqipëri ose jashtë saj. Shoqëria gjithashtu mund të kryejë çdo veprimtari tjetër të ligjshme që e gjykon të nevojshme për përmbushjen e qëllimeve të saj. Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.*

#### 6.2 Në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë të gjitha aktivitetet e dobishme ose të nevojshme të lejuara nga ligji, me qëllim realizimin e objektit të Shoqërisë.

## Neni 7

### Kapitali i Shoqërisë

#### 7.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale 100 (njëqind).

## Neni 8

### Zmadhimi i Kapitalit

- 8.1 Ortaku i vetëm mund të vendosë të zmadhojë kapitalin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
- 8.2 Kontributet e ortakut mund të konsistojnë në të gjitha format e aktiveve të lejuar nga ligji, duke përfshirë edhe kontributet në natyrë.
- 8.3 Detyrimet e ortakut kundrejt shoqërisë do të mbulohen vetëm me pjesën e kapitalit të paguar prej tij. Ortaku nuk do të ketë asnjë përgjegjësi tjetër për detyrime të tjera të shoqërisë.



## **Neni 9**

### **Zvogëlimi i Kapitalit**

- 9.1 Zvogëlimi i kapitalit mund të kryhet në përputhje me të gjitha procedurat e parashikuara nga ligji shqiptar.

## **Neni 10**

### **Vendimmarrja**

- 10.1 Ortaku i vetëm është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë i cili ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së shoqërisë.
- 10.2 Ortaku i vetëm ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:
- (a) ndryshime dhe modifikime të Statutit;
  - (b) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - (c) ndryshimin e formës së shoqërisë ose ristrukturimin e saj;
  - (d) hapjen dhe mbylljen e degëve dhe zyra e përfaqësimit;
  - (e) transferimin e kuotës;
  - (f) shpërndarjen e fitimit;
  - (g) emërimin dhe shkarkimin e administratoreve, eksperteve kontabël dhe likuiduesve dhe përcaktimin e shpërblimit të tyre;
  - (h) miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin;
  - (i) përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;
  - (j) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - (k) miratimin e çdo çështje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar organit më të lartë vendimmarrës në ligji dhe në këtë Statut.

## **Neni 11**

### **Transferimi i Kuotës**

- 11.1 Ortaku i Vetëm në çdo kohë mund të transferojë kuotën e tij lirisht ndërmjet:
- shitblerjes;
  - dhurimit;
  - trashëgimisë; apo
  - ndonjë mënyre tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.



- 11.2 Në rast se shoqëria do të ketë në të ardhmen më shumë se një ortak, atëherë do të lindë nevoja për ndryshimin e këtij statuti, në mënyrë që të pasqyrohen të drejtat dhe detyrimet e tyre si edhe mënyra e organizimit të shoqërisë me më shumë se një ortak

## **Neni 12**

### **Procesverbali i mbledhjes së asamblesë së përgjithshme**

- 12.1 Vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, vendimet për:
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
  - shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
  - zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar;
  - investimet;
  - për riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.
- 12.2 Për çdo mbledhje dhe vendim të Ortakut të Vetëm do të mbahet një procesverbal.
- 12.3 Procesverbali duhet të mbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin tregëtar dhe një për ortakun (secilin ortak nëse shtohen në të ardhmen).
- 12.4 Procesverbali do të firmoset nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
- 12.5 Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesverbalit dhe shpërndarjen e tij.

## **Neni 13**

### **Administrimi i Shoqërisë**

- 13.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një administrator, i cili do të përfaqësojë individualisht Shoqërinë.
- 13.2 Administratori mund të autorizojë palë të treta që t'i përfaqësojnë ata në transaksione të veçanta.
- 13.3 Administratori do të organizojë dhe menaxhojë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ai është i autorizuar të përfaqësojë Shoqërinë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me të.
- 13.4 Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e Ortakut të Vetëm dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 13.5 Administratori, *ndër të tjera*, ka të drejtat e mëposhtme:
- a. përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe në gjykate;



- b. hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
- c. marrja e huave në emër të shoqërisë dhe vendosja mbi kushtet e huasë;
- d. përfundimin e marrëveshjeve mbi dhënien e huave;
- e. përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
- f. nënshkrimin e të gjithë dokumentave, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
- g. mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë;
- h. dhënien e moratoriumit debitorëve të Shoqërisë, heqjen dorë nga paditë që vijnë si pasojë e marrëdhënieve të Shoqërisë me palët e treta dhe/ose pranimin e këtyre padive;
- i. punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
- j. marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratori mund të udhëzojë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojë shumën e shpërblimit të tyre; administratori ka të drejtë të ngrejë padi dhe t'i tërheqë ato; të nënshkruajë marrëveshje gjyqësore, të mbylli marrëveshje arbitrazhi, të caktojë arbitra, të tërheqë paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërpresë procedimet;
- k. administratori ka të drejtë të marrë çdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- l. mbledhjen e shpenzimeve të Shoqërisë;
- m. administratori është përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;
- n. administratori është përgjegjës për përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse diçka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i ortakut të vetëm;
- o. thërret mbledhjen e ortakut; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve(ortakut);
- p. administratori është përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;

- 13.6 Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat dhe veprimet, me përjashtim të atyre që me ligj dhe nga ky akt janë të rezervuara për Asamblenë ose kufizohen nga ky akt apo legjislacioni i zbatueshëm.
- 13.7 Personi i mëposhtëm do të caktohet administrator për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë ripërtëritjeje:
- **Migena Paçuku**, shtetase shqiptare, lindur me 17.07.1991, Rrëshen, rezident në adresën: Nikolla Jorga, Pallati Begeja, Shk 5, Ap 24,, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 034779243, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

#### **Neni 14**

##### **Eksperti(ët) Kontabël të Autorizuar**

- 14.1 Eksperti(ët) Kontabël i Autorizuar do të emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm, nëse është e nevojshme.

#### **Neni 15**

##### **Viti financiar, pasqyrat vjetore financiare**

- 15.1 Viti financiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit.
- 15.2 Viti i parë financiar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.
- 15.3 Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar, nëse ka një të tillë, miratohen nga Ortaku i Vetëm
- 15.4 Miratimi i dokumenteve në lidhje me pasqyrat financiare do të kryhet çdo vit, brenda tre muajve nga mbarimi i vitit përkatës financiar.

#### **Neni 16**

##### **Prishja dhe likuidimi**

- 16.1 Shoqëria do të zgjidhet në rastet e mëposhtme:
- vendim i mbledhjes së ortakut të vetëm;
  - bashkimi me një shoqëri tjetër;
  - vendimi i gjykatës me juridiksion përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
  - në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.
- 16.2 Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.





## Neni 17

### Të Përgjithshme

- 17.1 Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin midis ortakut dhe shoqërisë dhe/ose si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, palët do të përpiqen t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja do të zgjidhet nga Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane.
- 17.2 Ky akt hartohet duke u bazuar në legjislacionin shqiptar, interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimi i tij, duhet të kryhen në përputhje me parashikimet e legjislacionit shqiptar. Përsa nuk është parashikuar në këtë akt do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*", të ndryshuar.
- 17.3 Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në 2 (kopje) kopje origjinale.

### ORTAKU I VETEM

Znj.

Elipena Paucku

